



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e turizmit
“World Travel Market London”

Data e organizimit:
04-06 Nëntor 2025
Adresa: Londër, Angli

Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset e sektorit të turizmit të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë.

Ky aktivitet organizohet nga KIESA në koordinim dhe bashkëpunim me projektin FEGO – Swisscontact. KIESA/FEGO mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e standës, regjistrimin për pjesëmarrjen maksimumi deri të 10 bizneseve (operatorë turistik). Angazhimi i konsulencës për arranzhimin e takimeve B2B, parapërgatitjes së bizneseve pjesëmarrëse për prezantim në panair, dhe promovimi i ofertës në kanalet zyrtare të komunikimit të panairit do të mbulohen nga projekti FEGO – Swisscontact. Ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese etj., të bizneseve pjesëmarrëse do të mbulohen nga vet bizneset.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 16.09.2025 Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar me të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;

7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK-së, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme, aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet.

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet turistike inbound që do të ju ofrohen turistëve në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt turistik inbound
 - 3 pikë për 2 produkte turistike inbound
 - 5 pikë për 3 produkte turistike inbound
 - 7 pikë për 4 produkte turistike inbound
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte turistike inbound
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 5 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 4 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Aktiviteti primar turistik i subjektit aplikues, maksimum 10 pikë:
 - Tour operatorë 10 pikë
- Pjesëmarrja në panaire periudha 2022-2024
 - Nje (1) panaire, dy (2) pikë
 - Dy(2) panaire katër (4) pikë
 - Tre (3) panaire gjashtë (6) pikë,
 - Katër (4) panaire tetë (8) pikë
 - Pesë (5) e më shumë panaire dhjetë(10) pikë

Më 08.09.2025, në ora 09:30, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashkë me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 16.09.2025 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësi për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net